

Protokoll për veprim të shkollave fillore në Republikën e Maqedonisë së Veriut për realizimin e procesit edukativo – arsimor me prani fizike të nxënësve në vitin shkollor 2020/2021

- ❖ Procesi mësimor në shkollë zhvillohet nga ora 07:00 deri ora 20:00.
- ❖ Shkolla për hyrje dhe dalje të nxënësve vendos në funksion të gjitha hyrjet e objektit shkollor dhe përgatit orar për hyrje/dalje në kohë të ndryshme për hyrjen dhe daljen e nxënësve për çdo klasë dhe e vendos në vende të dukshme në shkollë.
- ❖ Lëvizja gegjesisht qarkullimi i nxënësve dhe punonjësve mbrenda dhe jashtë shkollës zhvillohet në mënyrë rigoroze, me vendosjen e shenjave të cilat tregojnë drejtimin e lëvizjes dhe mbrojtjen e distancës së nevojshme minimum prej 1,5 metër gjatë pritjes radhë të nxënësve para dhe mbrenda në shkollë .
- ❖ Për hyrje dhe dalje të kontrolluar në /nga shkolla, para dhe mbrenda në shkollë, organizohet shërbim për mbajtjen e rendit, me qëllim të mbajtjes së rendit dhe mbajtjes së distancës së nevojshme në mes nxënësve minimum prej 1,5 metër edhe atë 2 mbajtës të rendit para hyrjes në shkollë dhe 2 nga radhat e të punësuarve në shkollë. Mbajtësit e rendit angazhohen nga stafi i punonjësve në shkollë, ku vendos drejtori i shkollës fillore.
- ❖ Në hyrje të shkollës, korridore dhe klasa vendosen materiale edukative-informues, udhëzues për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurinë në shkollë dhe mjete për dezinfektimin e duarve.
- ❖ Prindërit / kujdestarët i dërgojnë nxënësit deri të hyrja e caktuar e shkollës dhe ndalohet hyrja e tyre në shkollë, përveç për prindërit/ kujdestarët dhe asistentët arsimor fëmijët e të cilëve janë me nevoja të veçanta arsimore me mbajtjen e obligueshme të maskës/ mbulimin e fytyrës.
- ❖ Nxënësit në secilën hyrje të shkollës i pret mësimdhënësi kujdestar, i cili kujdeset që nxënësi t'i dezinfektojë këpucët dhe duart, përkatësisht i ndihmon nxënësit t'i dezinfektojnë duart me mjete dezinfektuese.
- ❖ Nxënësve të cilët udhëtojnë me transport të organizuar, u matet temperatura para hyrjes në autobus dhe bëhet dezinfektimi i duarve dhe këpucëve, Nxënësit që kanë temperaturë (mbi 37.4°) kthehen në shtëpi me rekomandim që prindi të marrë masat e duhura shëndetësore.
- ❖ Punonjësit dhe nxënësit në shkollë gjatë hyrjes në shkollë, gjatë qëndrimit në shkollë dhe gjatë mësimi janë të obliguar të rrespektojnë masën për mbajtjen e distancës fizike së paku 1,5 metër dhe të mbajnë maskë/ mbulesë të fytyrës përveç kur gjenden në hapësira të hapura në oborrin e shkollës duke ruajtur distancën e rekomanduar.
- ❖ Punonjësit në shkollë gjatë hyrjes në shkollë janë të obliguar të dezinfektojnë këpucët dhe duart.
- ❖ Të gjithë punonjësve ju matet temperatura trupore para hyrjes në shkollë me termometër digjital pa kontakt fizik, ndërsa në rast të rritjes së temperaturës (mbi 37.4°) punonjësi drejtohet tek mjeku amë.

- ❖ Nxënësve para hyrjes në shkollë, Ju matet temperatura trupore me termometër digjital pa kontakt fizik. Në rast të rritjes së temperaturës trupore (mbi 37.4°) nuk lejohet hyrja e nxënësit në shkollë ndërsa prindi drejtohet për konsultim tek mjeku amë i nxënësit. Fëmijët me simptoma të sëmundjeve tjera ngjitëse gjithashtu nuk duhet të lejohen të shkojnë në shkollë.
- ❖ Mësimi në klasë realizohet më së shumti me 20 nxënës në klasë dhe sigurohet distancë fizike prej 1,5 metër ndërmjet mësimdhënësit dhe nxënësve dhe nxënësve ndërmjet vete.
- ❖ Nëse mësimi realizohet në vend të hapur në oborrin e shkollës, rekomandohet që të mos mbajnë maska/ mbulesë të fytyrës, mirëpo të respektohet distanca fizike ndërmjet nxënës- nxënës dhe mësimdhënës- nxënës së paku 1,5 metër.
- ❖ Mësimdhënësit duhet t'iu shmangin qëndrimeve të gjata në zyrën e mësimdhënësve , ndërsa duhet të mbajnë distancën e nevojshme fizike prej 1.5 metër.
- ❖ Nxënësit e një paralele qëndrojnë në një hapësirë dhe ndalohet mësimi nëpër kabinetet, përshkak të kujdesit ndaj shëndetit të nxënësve.
- ❖ Çdo herë kur është e mundur dhe kur lejojnë kushtet klimatike, mësimi të realizohet jashtë klasës në oborrin e shkollës, në natyrë.
- ❖ Dita e parë e mësimi fillon duke udhëzuar nxënësit në lidhje me atë se si duhet të sillen drejtë dhe sigurt, të mbajnë distancën fizike, higjienën e duarve dhe mbrojtjen e shëndetit të tyre , shëndetin e nxënësve tjerë dhe punonjësve tjerë në shkollë.
- ❖ Ndalohet përshëndetja me kontakt fizik për punonjësit në shkollë dhe nxënësit.
- ❖ Gjatë orëve të mësimi dhe gjatë pushimeve, është i obliguar që me nxënësit të qëndrojnë mësimdhënësi/udhëheqësi i klasës dhe të kujdeset për respektimin e distancës fizike ndërmjet nxënësve.
- ❖ Shkëmbimi i informacioneve me njeri-tjetrin dhe takimet e punës në shkollë duhet të realizohen duke shfrytëzuar lidhje video konferencash.
- ❖ Hapësirat të cilat më së shpeshti janë të ekspozuar ndaj prekjës, nga ana e punonjësve në shkollë dhe nxënësve, dezinfektohen në fillim dhe në fund të çdo ndrimi më së paku dy herë në ditë. Shkolla përgatitë listë për të gjitha hapësirat të cilat rregullisht duhet të pastrohen.
- ❖ Pastrimi i klasave bëhet para fillimit të mësimi, gjatë kohës së pushimit kur nxënësit janë në oborrin e shkollës dhe pas përfundimit të të gjitha aktiviteteve, me ujë dhe sapun/ detergjent dhe me mjete dezinfektuese të cilët veprojnë ndaj viruseve sipas udhëzimeve të prodhuesit.
- ❖ Përdorimi i tualeteve organizohet në mënyrë që të mundësohet prani më e vogël e nxënësve dhe mbajtja e distancës (p.sh. nëse tualeti është i vogël nxënësi duhet të pres jashtë tualetit derisa të dalë nxënësi i cili gjendet brenda).
- ❖ Tualetet duhet të jenë funksionale në mënyrë që të sigurojnë kushte për larjen më të shpeshtë të duarve me ujë dhe sapun dhe më shpesh të pastrohen duke mbajtur shënime të obligueshme për pastrimin dhe dezinfektimin me mjetet të cilat veprojnë ndaj viruseve sipas udhëzimeve të prodhuesit në mënyrë alternative

mund të përdoret hipoklorit të natriumit 0.1 % (5% zbardhues për amvisëri i cili përdoret në raport 1:100) ose 70 % alkool për dezinfektimin e hapësirave të sipërme.

- ❖ Sallat, shkollat dhe hapësirat tjera të përbashkëta pastrohen më së shpeshti, derisa nxënësit janë në mësim dhe pas përfundimit të të gjithas aktivitetëve shkollorë.
- ❖ Pastrimi i sallës së fizkulturës dhe fushave sportive, zhveshtoreve, dhe hapësirave tjera ndihmëse, bëhet menjëherë pas shfrytëzimit nga ana e çdo grupi të nxënësve.
- ❖ Shkollat zbatojnë sistem për lëvizje njëkahëshe të nxënësve nëpër hapësira si dhe kufizojnë numrin e personave të cilët njëkohësisht janë të pranishëm në zhveshtore si dhe daljet e kontrolluara dhe hyrjet në zhveshtore .
- ❖ Hapësirat detyrimisht të ajrosen pas përfundimit të çdo ore mësimore, më së paku gjysëm ore para ardhjes dhe pas shkuarjes së nxënësve.
- ❖ Gjatë orës së mësimin në klasë, nëse lejojnë kushtet klimatike preferohet që dritarja të jetë e hapur. Në klasat (nëse shkolla disponon) rekomandohet që të shmangiet shfrytëzimi i koncidionerëve.
- ❖ Drejtori i shkollës fillore duhet të emërojë persona nga ana e punonjësve të cilët në vende të caktuara do të jenë në rolin e mbikqyrësve dhe gjithashtu do të mund t'i ndihmojnë ata nxënës të cilat kanë pyetje dhe kanë nevojë për mbështetje për të kuptuar masat për mbrojtjen e tyre.
- ❖ Nxënësit vijnë dhe shkojnë vetë në shkollë, të shoqëruar nga prindi/kujdestari/ asistenti personal me transport të organizuar ose transport publik. Transportuesit të cilët transportojnë nxënësit respektojnë dhe zbatojnë protokollet për transportin e udhëtarëve.
- ❖ Bartja e informacioneve dhe takimet me prindërit/ kujdestarët bëhen përmes telefonit ose përmes ndonjë aplikacioni online për të cilën do të merren vesh prindërit dhe mësimdhënësit.
- ❖ Nxënësit me qëndrim ditor mund të shfrytëzojnë ushqim nga kuzhinat e shkollës që kanë detyrime të punojnë me respektim të përpiktë të rregullave për praktikë higjienike dhe të prodhuar të përcaktuar me Ligjin për Sigurim të Ushqimit, si dhe standardet dhe Protokollet e HACCP për mbrojtje nga COVID-19. Shërbimi i racioneve për nxënësit me qëndrim ditor duhet të realizohet në tryezat e shkollës, duke mbajtur llogari që të mos vije deri te përzjerja e nxënësve nga paralelet të ndryshme.
- ❖ Nxënësit vetëm kur e konsumojnë racionin ju lejohe të largojnë maskën/ mbulesën nga fytyra.
- ❖ Nxënësit i lajnë duart para dhe pas ngrënies, para dhe pas përdorimit të tualetit para dhe pas ardhjes nga jashtë dhe kur duart duken të ndyta/përlyera.
- ❖ Shfrytëzimi i sallës së fizkulturës, bibliotekës dhe hapësirave tjera duhet të bëhet nga grupi i nxënësve të të njëjtës paralele, ashtu që të mos ekzistojë mundësia e përzjerjes së një numri të madh të nxënësve nga paralelet e ndryshme (psh. gjatë

një ore mësimore, një paralele është në sallën e fizkulturës, ndërsa dy paralele janë jashtë në oborrin e shkollës ose në fushat sportive).

- ❖ Kalimi nëpër hapësirat e përbashkëta duhet të organizohet në mënyrë që nxënësit dhe mësime të mësimdhënësit e njëjës paralele kalojnë, ndërsa nxënësit dhe mësime të mësimdhënësit e paraleleve tjera presin radhën e tyre duke i udhëzuar nxënësit që mos t'i prekin hapësirat ose objektet ku lëvizin.
- ❖ Duhet të shmanget hyrja e personave të tjerë (p.sh, pastrim, riparim ose sjellje të ushqimit) nëpër klasa derisa nxënësit gjenden aty, si dhe hyrja në objektin shkollor të personave të cilët nuk janë të punësuar në shkollë ose nxënësve të cilët nuk janë nxënës të asaj shkolle.
- ❖ Dërgesat për nevojat e shkollave e marrin përgjegjësit, punonjësit në shkollë nga hyrja dytësore e shkollës (nëse ekziston një hyrje e tillë), ndërsa hyrja kryesore lejohet vetëm për tekniket e shërbimeve ose ofruesit tjerë të shërbimeve të cilat janë të domosdoshëm (p.sh. zbatimi i masave parandaluese dhe masave epidemiologjike siç janë kontrollimi i ujit të konsumueshëm, siguria e ushqimit etj) me respektimin e detyrueshëm të masës për dezinfektimin e duarve si dhe mbajtja e maskës mbrojtëse/ mbulesës së fytyrës dhe mbrojtës së këpucëve.
- ❖ Nëse në shkollë paraqitet ndonjë person i sëmurë me COVID -19 ose person i cili ka pasur kontakt me të sëmurë me COVID -19, personi duhet të izolohet në hapësirë të veçantë me mbajtje të obligueshme të maskës/ mbulimit të fytyrës, ndërsa drejtori duhet të komunikojë me Qendrën për Shëndet Publik për marrjen e udhëzimeve për veprim të mëtutjeshëm.
- ❖ Për aktivitetet e ndërmarra shkolla dorëzon raport në komunë, ndërsa komuna në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.
- ❖ Nëse nxënësi shfaq simptoma të COVID-19 deri sa është në shkollë mësime të mësimdhënësi/bashkëpunëtori profesional izolon nxënësin në hapësirë të veçantë dhe menjëherë i njofton prindërit / kujdestarët , të cilët në periudhë sa më të shkurtër kohore duhet të marrin fëmijun me qëllim të konsultimit dhe veprimit të mëtutjeshme me mjekun amë të nxënësit.
- ❖ Nëse konfirmohet se nxënësi është i sëmurë me COVID -19, njoftohet shërbimi epidemiologjik në Qendrën për Shëndet Publik i cili urgjentisht duhet të realizojë pyetësor me mësime të mësimdhënësit dhe nxënësit për vlerësimin e nivelit të rrezikshmërisë në bazë të kontakteve të cilat i kanë pasur.

Vërejtje: Për shkak të veprimtarisë specifike të shkollave fillore shtetërore (shkolla fillore me qendra burimore , shkolla fillore me qendra burimore dhe akomodim në konvikte, shkolla shtetërore për muzikë dhe balet) në kërkesën për mësim me prani fizike në shkollë dorëzon plan me masa plotësuese për mbrojtje nga COVID-19.